



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1528/ 21prot.

Datë 22.08.2024

V E N D I M
Nr. 1102/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkyetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.08.2024 , mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.758/2024, datë 26.06.2024 dhe vendimit 801/2024 datë 04.07.2024 dhe vendimit 924/2024 datë 22.07.2024 për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-07868-06-04-2024, me objekt: “Blerje pajisje kompjuterike”, me fond limit 1,250,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK me NIPT L82428011G dhe adresë, Rruga: “Fortuzi 66/1”, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Bulqizë
Adresa: Lagjja “Minatori”.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 26.06.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.758/2024 , ku vendosi: [...]*1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “BluePrint Technologies” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-07868-06-04-2024, me objekt: “Blerje pajisje kompjuterike”, me fond limit 1,250,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.*

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, gjithashtu dhe sqarimet të publikohen

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “BluePrint Technologies” SHPK.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2 Ne datën 04.07.2024 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.801/2024, ku vendosi:

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm për procedurën e prokurimit E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-07868-06-04-2024, me objekt: “Blerje pajisje kompjuterike”, me fond limit 1,250,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.

2. Autoriteti Kontraktor të zbatojë plotësisht vendimin e KPP-së Nr. 758/2024 datë 26.06.2024.

3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

I.3 Në datën 22.07.2024 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.924 /2024, ku vendosi:

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm për procedurën e prokurimit E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-07868-06-04-2024, me objekt: “Blerje pajisje kompjuterike”, me fond limit 1,250,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.

2. Autoriteti Kontraktor të zbatojë plotësisht vendimin e KPP-së Nr. 758/2024 datë 26.06.2024.

3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

I.4. Me shkresën nr.4093 prot., datë 14.08.2024 protokolluar me tonën nr. 1528/18 prot., datë 16.08.2024 autoriteti kontraktor, njofton se “Mbështetur ne ligjin nr 139/2015 "Per vetegeverisjen

vendore", Ligji nr 162/2020 "Për Prokurimin Publik" I ndryshuar, neni 115, Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, Neni 118 Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe Vendimit nr 924/2024 prot, date 22.07.2024. Ne lidhje me Vendimin nr 924/2024 prot, date 22.07.2024, ku ju vendosni të mos lejoni Autoritetin Kontraktor që të vijoje me hapat e metejshme të procedurës së prokurimit me objekt "Blerje Paisje Kompjuterike", me REF-07868 -06-04-2024, ne lidhje me ankesën të Operatorit Blueprint Technologies për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje Paisje Kompjuterike" Duke qenë se jemi në fazën ku Autoriteti Kontraktor nuk mund të ngarkojë shtojcë të re me sqarimet perkatese, kërkojmë nga ana juaj heqjen e pezullimit të procedurës për të bërë anulimin e saj për të ngarkuar një procedurë të re, ku do të pasqyrohen dhe sqarimet perkatese sipas vendimit nr 758/2024 të KPP-se.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

I.3. Meshkresën nr.4093 prot., datë 14.08.2024 protokolluar me tonën nr. 1528/18 prot., datë 16.08.2024 autoriteti kontraktor, njofton se “Mbështetur në ligjin nr 139/2015 “Per vetegeverisjen vendore”, Ligji nr 162/2020 “Për Prokurimin Publik” I ndryshuar, neni 115, Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, Neni 118 Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe Vendimit nr 924/2024 prot, date 22.07.2024. Ne lidhje me Vendimin nr 924/2024 prot, date 22.07.2024, ku ju vendosni të mos lejoni Autoritetin Kontraktor që të vijoje me hapat e metejshme të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Paisje Kompjuterike”, me REF-07868 -06-04-2024, ne lidhje me ankesën të Operatorit Blueprint Technologies për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Paisje Kompjuterike” Duke qenë se jemi në fazën ku Autoriteti Kontraktor nuk mund të ngarkojë shtojcë të re me sqarimet perkatese, kërkojmë nga ana juaj heqjen e pezullimit të procedurës për të bërë anulimin e saj për të ngarkuar një procedurë të re, ku do të pasqyrohen dhe sqarimet perkatese sipas vendimit nr 758/2024 të KPP-se.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik Komisioni Prokurimit Publik vëren se autoriteti kontraktor kërkon lejimin mbi anulimin e procedurës pasi në fazën që ndodhen nuk mund të ngarkojnë shtojcë të re.

KPP gjykon se autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë të anulojë procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe me rihedhjen të këtë parasysh të gjitha konstatimet e kryera në vendimet nr Nr.758/2024, datë 26.06.2024 dhe vendimit 801/2024 datë 04.07.2024 dhe vendimit 924/2024 datë 22.07.2024

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm për anulimin e procedurës e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-07868-06-04-2024, me objekt: “Blerje pajisje kompjuterike”, me fond limit 1,250,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.
2. Autoriteti Kontraktor me rihedhjen e procedurës të sjellë DST e reja në zbatim të vendimit të KPP-së Nr. 758/2024 datë 26.06.2024.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro